



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 61 Akti**

**Nr. 68 Vendimi**

Tiranë, më 08.10.2018

**V E N D I M**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

<b>Suela Zhegu</b>	Kryesuese
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Brunilda Bekteshi</b>	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, më datë 3 tetor 2018, ora 12:00, në ambientet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Sotiraq Lubonja**, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

**OBJEKTI:** Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/ b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

## TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, në seancë dëgjimore publike, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësinë e saj,

### V Ë R E N:

#### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Sotiraq Lubonja është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë. Në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e në vijim referuar si “Komisioni”) ka hedhur shortin më datë 15.01.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi nga trupi gjykues nr. 3.

2. Me vendimin nr.1, datë 24.01.2018, të trupit gjykues, është vendosur kryesuese znj. Suela Zhegu, është deklaruar mospasja e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues, si dhe fillimi i hetimi administrativ kryesisht nga relatori. Vëzhgues ndërkombëtar për këtë subjekt rivlerësimi është caktuar znj. Marie Tuma.

3. U administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga:

- a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”), sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016;
- b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe
- c) Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Në vijim, nga ana e relatorit të çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nganeni 14, pika 5, i ligjit nr. 84/2016.

5. Subjekti i rivlerësimit u njoftua për përbërjen e trupit gjykues më datë 31.05.2018. Ai deklaroi se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

6. Më datë 14.09.2018, trupi gjykues, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes, vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit z.Sotiraq Lubonja, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit dhe ta ftojë atë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, paraqitjen e shpjegimeve dhe provave për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.

7. Subjekti i rivlerësimit e ushtroi të drejtën për t’u njohur me dosjen dhe paraqiti brenda afatit të caktuar nga Komisioni shpjegime lidhur me barrën e provës, si dhe disa prova të reja për të provuar një nga rezultatet e hetimit, të cilat trupi gjykues vendosi t’i pranojë dhe t’i administrojë në dosjen e subjektit.

8. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore të datës 03.10.2018, ora 12:00, me njoftimin e bërë elektronikisht më datë 27.09.2018.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

9. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr.84/2016, më datë 03.10.2018, ora 12:00, në ambientet e godinës së Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

10. Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë, ai shpjegoi lidhur me rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin e tij në detyrë.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

11. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr.84/2016. Anëtarët e Komisionit hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indice në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Komisioni ka kryer procesin e rivlerësimit për z. Sotiraq Lubonja mbi tri kriteret vlerësimit të parashikuara në nenin 4,pika 1, të ligjit nr. 84/2016, (a) vlerësimin e pasurisë, (b) kontrollin e figurës dhe (c) vlerësimin e aftësive profesionale.

13. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, sëbashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga Inspektorati i Këshilli tëLartë tëDrejtësisë, sëbashku me materialin shoqërues;
- d) Provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- ç) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- ç) Denoncimet nga publiku;
- d) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, si edhe provat e paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht dhe në seancën dëgjimore.

13.1 Trupi gjykues, gjatë hetimit të çështjes administroi:

- Dokumente të tjera shkresore, nga organet publike dhe private, përveç atyre që ka administruar ILDKPKI-ja.
- Prova të reja, përgjigje dhe shpjegime nga ana e subjektit të rivlerësimit.

### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

14. Subjekti i deklaramit, z. Sotiraq Lubonja, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33<sup>1</sup> të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

---

<sup>1</sup>Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramet e pasurive zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

14.1 Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky institucion në raportin e tij ka konkluduar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr.84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse<sup>2</sup>.

16. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z.Sotiraq Lubonja, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

17. Pas hetimit administrativ të zhvilluar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka në pronësi pasuri të paluajtshme si vijon:

**18. Pasuria shtëpi baniminë Korçë**, sip. trualli ndërtimi 61 m<sup>2</sup>, me dy kate + papafingo, adresa L.\*\*\*, Rr.“\*\*\*\*”, nr. \*\*\*. Pjesa që zotëron subjekti: 66.66%.

19. Mënyra e fitimit: (1) me kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., **datë 09.07.2002**, për 1/3-ën pjesë të pasurisë dhe (2) me kontratë dhurimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., **datë 12.07.2007**, për 1/3-ën pjesë të pasurisë, nga dhuruesit N. K. K dhe M. Sh (K.).  
Certifikatë për vërtetim pronësie, **datë 17.07.2007**, për truall me sip. 173 m<sup>2</sup>, dhe ndërtesë me sip. 62 m<sup>2</sup>, Rr. “\*\*\*\*”, Korçë, me bashkëpronarë M. Sh (1/3) dhe Sotiraq Lubonja (2/3).

20. Origjina e pronës: me vendimin nr.1326, datë 05.01.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Korçë, shtetasve N. Q, M. Sh dhe K. L (K.) u kthehet shtëpia 1-katëshe dhe 2-katëshe në krah të njëra-tjetrës dhe kanë secili 1/3-ën pjesë.

21. Vlera e deklaruar në formularin “Vetting”: 2.500.000 lekë.Të ardhura me pagat e familjes. Në proces regjistrimi për shkak të regjistrimit pilot financiar nga USAID-i.

Në vitin 2016, nga eksperti z. P. T (me licencë nr.regj. VP \*\*\* për vlerësim në fushën “Ndërtesa dhe tokë truall”) është rivlerësuar trualli 173 m<sup>2</sup> dhe vetëm një kat me sipërfaqe 62 m<sup>2</sup>, në vlerën 4.397.592 lekë, duke qenë se me këto të dhëna prona paraqitet e regjistruar në ZVRPP-në Korçë (shtëpia ekzistuese). Shtesat e kryera në shtëpinë ekzistuese nuk janë legalizuar.

<sup>2</sup>Vendimi nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

22. Nga procesi i verifikimit të kësaj pasurie, ILDKPKI-jakonkludon:

- *Fshehje nga ana e subjektit të kërkesës për legalizim të ndërtesës 2 kat + papafingo, L. \*\*\*, Rr. “\*\*\*”, nr. \*\*\*, Korçë, në deklaratën e vitit 2006 në ILDKPKI.*
- *Fshehje e sipërfaqes totale të banesës (pjesa e dhuruar dhe shtesa e ndërtuar) dhe deklarim i rremë i shumës së investuar për ndërtimin pa leje. Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për shumën e investuar për shtesën dhe mungesë burimesh të ligjshme financiare, gjykuar nga sipërfaqja e saj. Referuar ALUIZNI-t, sipërfaqja shtesë për banim është 395 m<sup>2</sup>.*
- *Ndërtimi i paligjshëm i shtesës së kryer në banesën e ndodhur në L. \*\*\*, Rr. “\*\*\*”, nr. \*\*\*, Korçë, bie ndesh jo vetëm me ligjin penal shqiptar (ndërtimi i paligjshëm parashikohet si vepër penale në nenin 199/a të Kodit Penal), por edhe me funksionin e subjektit, si dhe komprometon shumë rëndë figurën e tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë.*

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

23. Pas administrimit të dokumenteve nga ZVRPP-ja Korçë, konstatohet se pasuria \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, me sipërfaqe trualli 173 m<sup>2</sup> dhe ndërtimi 62m<sup>2</sup>, ndodhur në Korçë, Rr. “\*\*\*”, aktualisht Rr. “\*\*\*”, ka qenë në pronësi të N. K, M Sh. (K.) dhe K. L (K.). Kjo pronë u është njohur dhe kthyer atyre si ish-pronarë me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave të Bashkisë Korçë, nr. \*\*\*, datë 05.01.1996.

24. Nga administrimi i dokumenteve konstatohet se subjektit të rivlerësimit i është dhuruar 1/3-ta pjesë nga shtetasi N. K, në vitin 2002 dhe 1/3-ta pjesë nga shtetasja K. L (K.), në vitin 2007. Shtetasja M. Sh (K.) rezulton aktualisht si bashkëpronare në këtë pronë me subjektin e rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja.

25. Deklarimi i subjektit të rivlerësimit, se me kontratën e dhurimit, datë 09.07.2002, dhe datë 12.07.2007, ka përfituar 2/3-ën pjesë nga dhuruesit N. K. K dhe M. Sh (K.) nuk janë të sakta, pasi dhurues rezultojnë të jenë shtetasit N. K dhe K. L (K.).

26. I pyetur për arsyen e dhurimit dhe marrëdhënien me këta shtetas, subjekti i rivlerësimit sqaron se gjyshja dhe gjyshi i subjektit janë kujdesur për z. K. K dhe djalin e tij, kur këta kanë qenë në burg. Ka marrëdhënie miqësore, por edhe shpirtërore, dhe dhurimi është një amanet i lënë nga prindërit e dhuruesve. Znj. M. Sh nuk arriti ta bëjë këtë dhurim, pasi ka vdekur në vitin 2018 në SHBA, duke mos dhënë shpjegime se përseai nuk është realizuar deri para vdekjes.

27. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka një akt përfaqësimi, prokurë e përgjithshme e datës 17.09.1999, e mbajtur në SHBA (*depozituar pranë Komisionit*), ku njëri prej dhuruesve të shtëpisë, z. N. K, emëron për kryerjen e veprimeve juridike lidhur me pronat e paluajtshme të tyre në Korçë subjektin e rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja.

28. Në shtëpinë e banimit në Korçë rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer ndërtim pa leje, duke bërë shtesë anësore dhe shtesë kati + papafingo. Drejtoria ALUIZNI-t Korçë, konfirmon se:

- a) Subjekti i rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, ka aplikuar me vetëdeklarimin nr. \*\*\*, datë 08.11.2006, për një ndërtim informal të ndodhur në L. \*\*\*, Rr. “\*\*\*”, nr. \*\*\*, Korçë. Sipërfaqja faktike e bazës së ndërtimit rezulton të jetë 121.4 m<sup>2</sup>, në total sipërfaqja shtesë që shfrytëzohet për banim 395.3 m<sup>2</sup>.
- b) Nga fotografimet ajrore (*ortofoto*) të viteve 2007 dhe 2015, gjatë kësaj periudhe nuk vërehen ndryshime në ndërtimin informal të banesës së z. Sotiraq Lubonja.

c) Drejtoria ALUIZNI-t Korçë nuk është shprehur ende në lidhje me vetëdeklarimin e z. Sotiraq Lubonja, duke vijuar procedurat e legalizimit.

29. Në vitin 2003 në “Deklaratën e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shtëpi banimi me sip. 61 m<sup>2</sup>, dy kate + papafingo, dhe vlerën përkatëse 2.500.000 lekë. Të njëjtin deklarim ka bërë edhe në deklaratën “Vetting”. Ai nuk ka deklaruar sipërfaqen e truallit prej 173 m<sup>2</sup> në deklaratimet e tij.

30. Subjekti i rivlerësimit ka poseduar prej vitit 1995 deri në vitin 2002 pronën pa një akt të ligjshëm, si dhe prej vitit 2002 në vitin 2007, e në vijim, poseduar pjesët, sipas kontratave të dhurimit.

31. Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar të saktë sipërfaqen e shtesës ndërtim pa leje, vitin se kur e ka kryer këtë ndërtim pa leje (*shtesë anësore dhe shtesë kati*) dhe a ka pasur përmirësime të pronës ndër vite, të cilat mund të kenë rritur koston e ndërtesës. Ai ka deklaruar si burim për krijimin e kësaj prone të ardhurat nga paga.

32. Referuar informacionit të mbledhur nga deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, rezulton se ndërtimi është kryer nga viti 1996 - 2002. Në përgatitjen e analizës ekonomike lidhur me koston mesatare të ndërtimit dhe mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për ndërtimin e kësaj prone, Komisioni iu referua vendimit nr. 13, datë 05.01.1998, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave, të vleftave mesatare të tregut të lirë të banesave dhe të koeficientit (k)”, ku kostoja mesatare e ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 1997 është 16.138 lekë/m<sup>2</sup> për sipërfaqe ndërtimi.

33. Sipas vlerës së referencave të vendimit nr. 13, datë 05.01.1998, të Këshillit të Ministrave, kostoja e ndërtimit të banesës së subjektit të rivlerësimit llogaritet në vlerën prej **6.379.351 lekësh**. Kjo kosto është disa herë më e lartë se kostoja e deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe se ai nuk ka treguar se si e ka ndërtuar këtë shtëpi referuar vlerësë vetëdeklaruar dhe saktësisht kohën/vitet kur e ka ndërtuar. Sipas kësaj llogaritjeje, subjekti nuk ka pasur mjetet e nevojshme financiare për ndërtimin e kësaj banese në periudhën 1996-2002, duke iu referuar koston mesatare të ndërtimit.

34. Nga hetimi konstatohen pasaktësi në deklaratimet e subjektit lidhur me dhurimin e pronës. Aktualisht, ende subjekti rivlerësimit posedon 1/3-ën pjesë, pa ndonjë dokumentacion ligjor. Nuk ka dokumentacion ligjor provues mbi posedimin e ndërtesës ekzistuese prej 62 m<sup>2</sup> dhe truallit prej 173 m<sup>2</sup>, në pronësi të familjes K., prej vitit 1995 - 2002 dhe 2007.

35. Ka mospërputhje ndërmjet deklaratimit në deklaratën “Vetting” dhe atij periodik të vitit 2003 nga njëra anë dhe dokumenteve të administruara nga institucionet shtetërore në lidhje me sipërfaqen e truallit, sipërfaqen e bazës ndërtimore dhe sipërfaqen e secilit kat. Nuk është deklaruar sipërfaqja prej 60.4 m<sup>2</sup> shtesë në bazën ndërtimore kati përdhe. Nuk është deklaruar sipërfaqja totale shtesë që shfrytëzohet për banim, prej 395.3m<sup>2</sup>.

36. Ndërtimi pa leje i banesës bie ndesh me legjislacionin shqiptar, por edhe me funksionin e gjyqtarit. Duket se ndërtimi pa leje është kryer në pronën e dikujt tjetër.

37. Mbështetur në nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës, nëse subjekti i rivlerësimit përpiket të fshehtë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjekti ka detyrimin të provojë të kundërtën.

**38. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, në bazë të nenit 52 të ligjit nr.84/2016, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera lidhur me këto rezultate hetimi.**

39. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi lidhur me rezultatet e vlerësimit të pasurisë nga ILDKPKI-ja se ato nuk qëndrojnë, pasi ai ka deklaruar pasurinë në deklaratën fillestare të pasurisë (v.2003), duke u shprehur edhe për kontratën e dhurimit për 1/3-ën pjesë të shtëpisë nga ish-pronari N. K, duke pranuar se objekti ekzistonte si i tillë (truall 108 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë 61 m<sup>2</sup> me dy kate, plus papafingo e ndërtuar deri më datë 05.07.2002).

Subjekti ka thënë se: *“Në vlerësimin tim nuk qëndron koncepti ‘fshehje’, konkluzion ky që ka arritur ILDKPKI-ja, sepse jo vetëm e kam shpjeguar, por edhe shumë kohë përpara, që në vitin 2003”.*

40. Lidhur me mosdeklarimin e ndërtimit pa leje dhe kërkesës së bërë pranë ALUIZNI-t, subjekti ka sqaruar se: *“Kam mendimin që konkluzioni i arritur nga ky organ për mosdeklarim të kërkesës nuk përputhet me ligjin, sepse kërkesa nuk është dokument pronësie dhe, për më tepër, kjo kërkesë e depozituar në organet e pushtetit lokal, më datë 08.11.2006, nuk është shqyrtuar nga ALUIZNI deri sot, më datë 26.09.2018.”*

Subjekti shpjegon se nuk qëndron koncepti *“fshehje”*, pasi deklarimi është bërë pa pasur qëllim për ta fshehur.

41. Lidhur me vlerën e investimit dhe pamundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për ndërtimin e shtesës (*shtesë anësore dhe shtesë kati në shtëpinë ekzistuese*), konkluzion ky i arritur nga ILDKPKI-ja, por edhe nga Komisioni, subjekti ka sqaruar se nuk ka fshehur sipërfaqe të ndërtuar në lidhje me vlerën e investimit pasi ndërtimi është bërë me të ardhurat nga paga dhe tullat e marra për ndërtimin e tij me një vlerë tepër të ulët dhe të mbajtura për 5 vjet në shtëpi.

42. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk u dukën bindëse për trupin gjykues, pasi edhe sikur të mbahet në konsideratë fakti i deklaruar nga subjekti, se tullat janë marrë me një vlerë tepër të ulët dhe janë mbajtur për 5 vjet në shtëpi, çmimi i përcaktuar për ndërtimin e sipërfaqes shtesë është disa herë më i ulët se ai i përlogaritur për ndërtimin e kësaj sipërfaqeje prej 395 m<sup>2</sup>, sipas një çmimi mesatar të ndërtimit në vitin 1997. Ndërkohë që shtëpia, sipas shpjegimeve të subjektit, është ndërtuar deri në vitin 2002, pa u përcaktuar saktësisht koha. Edhe nëse e përlogarisim koston e ndërtimit duke zbritur vlerën e tullave, përsëri ajo rezulton më e lartë se vlera prej 2.500.000 lekësh e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

43. Në deklarimin *“Vetting”*, por edhe në deklarimin periodik vjetor (*deklarimi fillestar v.2003*) subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi saktësisht sipërfaqen e shtëpisë, duke iu referuar sipërfaqes bazë të ndërtimit prej 62 m<sup>2</sup>, kur në fakt sipërfaqja faktike e bazës së ndërtimit sipas dokumentacionit rezulton të jetë 121.4 m<sup>2</sup> dhe në total sipërfaqja shtesë që shfrytëzohet për banim 395.3 m<sup>2</sup>.

44. Shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk e bindën trupin gjykues për të kundërtën e rezultateve të hetimit për këtë çështje. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të sipërfaqes reale të shtëpisë dhe ka pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, siç shpjeguar më lart.

45. Lidhur me konstatimin e ILDKPKI-së, se ndërtimi i paligjshëm bie ndesh jo vetëm me ligjin penal shqiptar (*ndërtimi i paligjshëm parashikohet si vepër penale në nenin 199/a të Kodit Penal*), por edhe me funksionin e subjektit, si dhe komprometon shumë rëndë figurën e tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë, subjekti ka sqaruar në shpjegimet e tij se: *“Ky ndërtim është kryer nga nëna për rrethana të cilat kam dhënë shpjegime. Në lidhje me konstatimet ILDKPKI-së, sqaroj që neni 199/a i Kodit Penal është miratuar nga ligjvënësi me ligjin nr. 176/2014 me titull “Ndërtim i paligjshëm”. Në konceptin tim, asnjë ligj material penal nuk ka fuqi prapavepruese, me përjashtim të efekteve përfutuese. Në leximin tim, Kodi Penal i miratuar nga Kuvendi i Republikës së*

*Shqipërisë, më datë 27.01.1995, nuk e ka këtë dispozitë. Në vijim, Kodi Penal me ndryshimet përkatëse me ligjin nr. 8279, datë 15.01.1998, përsëri nuk e ka këtë dispozitë. Në vazhdimësi, ndryshimet në Kodin Penal të vitit 2001; 2003; 2004 dhe së fundmi me ligjin nr. 9686, datë 26.02.2007, nuk e kanë këtë dispozitë. Atëherë cilin ligj kam shkelur? ”.*

46. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar gjithashtu në shpjegimet e tij se shtëpia ku ai banon aktualisht ka qenë shtëpia që kanë banuar gjyshja, gjyshi dhe prindërit e tij. Ajo ka qenë një shtëpi që u është kthyer ish-pronareve pas vitit 1995. Ishte një obligim i ish-pronarëve, mbështetur në marrëdhëniet familjare shumë të afërta, ku pronari i shtëpisë dhe gjyshi i subjektit të rivlerësimit kanë qenë miq, fëmijët e tyre janë rritur së bashku dhe dy nga fëmijët e tij janë dy personat që kanë bërë kontratat e dhurimit në favor të familjes Lubonja. Marrëdhënia me palën dhuruese është një marrëdhënie e krijuar edhe si detyrim moral ndaj personave të tjerë, jo në kuptimin e shpërblimit, por të respektit. Për shkak të marrëdhënies personale me ish-pronarët e truallit dhe të banesës, kemi qëndruar në banesë pa përfituar asnjë pronësi tjetër nga shteti shqiptar.

47. Në analizë të konkluzioneve të ILDKPKI-së, si dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, duke analizuar legjislacionin në fuqi, rezultoi se ndërtimet pa leje kanë filluar herët dhe ato kanë ardhur fillimisht si pasojë e kulturës së ulët juridike të shtetasve, të cilët nuk e kanë gjykuar të nevojshme të pajisen me leje ndërtimi apo vështirësive dhe procedurave të ndërlikuara të zbatuara nga organet e qeverisjes vendore për të pajisur subjektet me lejen e ndërtimit përkatëse. Në disa raste, edhe pamundësia fizike për marrjen e lejes kur ky proces ka qenë i pezulluar në njësitë respektive vendore. Në rastin në fjalë besohet se ndërtimi pa leje ka ardhur si pasojë e pamundësisë që ka pasur subjekti për të marrë një leje ndërtimi, pasi ai nuk ishte pronar i truallit në të cilin do të bëhej ndërtimi dhe as i banesës në të cilët do të bëhej shtesa. Subjekti ka pasur nevojë për shtesë të sipërfaqes së banueshme, por se ai nuk ka pasur mundësi reale për të marrë një leje ndërtimi si arsye e mungesës së dokumentacionit ligjor të nevojshëm.

48. Ligji nr. 7693, datë 06.04.1993, “Për urbanistikën”, i ka parashikuar ndërtimet pa leje si kundërvajtje administrative, duke parashikuar sanksione me gjobë. Ky ligj parashikonte edhe konceptin e “zënies arbitrare të truallit” por që në rastin e z. Sotiraq Lubonja mund të konsiderohet si një posedim i paligjshëm i kryer me mirëbesim.

Me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998, “Për urbanistikën”, u vijua me të njëjtin qëndrim, dhe për herë të parë u parashikua koncepti i legalizimit të objekteve pa leje të ngritura nga pronarët në pronat e tyre, me kusht shlyerjen e detyrimeve nga ndërtuesi.

Edhe me miratimin e ligjit nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, figura e veprës penale të ndërtimit të paligjshëm ende nuk ishte parashikuar.

Deri në vitet 2004, masat ishin vetëm të karakterit administrativ dhe me ligjin nr. 9209, datë 23.03.2004, “Për legalizimin e shtesave pa leje” dhe ligjin nr. 9304, datë 28.10.2004, “Për legalizimin dhe urbanizimin e ndërtimeve pa leje” u krijua një strukturë e posaçme për këtë proces. Iniciativa vijoi me miratimin e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006, “Për legalizimin, integrimin dhe urbanizimin e ndërtimeve pa leje”. Në vitin 2008 u bënë amendime në Kodin Penal, duke parashikuar për herë të parë ndërtimin pa leje si figurë më vete (ligji nr.10023, datë 27.11.2008), duke ndarë edhe konceptin mes ndërtimeve të kryera në tokën e vet dhe atyre në tokë shtetërore apo tokën e tjetrit (kjo e fundit ishte rrethënë rënduese).

49. Në këto kushte, mbi vlerësimin e bërë nga ILDKPKI-ja se ndërtimi i paligjshëm bie ndesh me ligjin penal shqiptar (*ndërtimi i paligjshëm parashikohet si veprë penale në nenin 199/a të Kodit Penal*), trupi gjykues vlerëson se është në kapërcim të parashikimeve ligjore dhe se ndërtimi pa leje i kryer nga subjekti i rivlerësimit apo nëna e tij (*anëtarët të së njëjtës familje*), bashkëpërfitues të kësaj prone, ka qenë kundërvajtje administrative.



50. Sa i përket parashikimit të ILDKPKI-së, se ky ndërtim bie ndesh me funksionin e subjektit si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë, Komisioni vlerësoi se subjekti asaj kohe ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Korçë dhe më tej, në vitin 2001, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë, dhe se ai duhet të kishte vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi e të aplikonte për leje ndërtimi apo shtesë, pasi të kishte poseduar këtë shtëpi, sipas legjislacionit në fuqi.

51. Në vlerësimin në tërësi të kësaj prone, rezulton se subjekti i rivlerësimit ishte konfuz në deklaratimet e tij lidhur me periudhën kur është ndërtuar kjo shtëpi saktësisht, duke treguar se tullat janë blerë herët, rreth viteve 1991, për një çmim të lirë, për të cilën solli vetëm disa foto, por se nuk tregoi qartazi se kur është ndërtuar konkretisht prona. Ai pretendon se ajo është ndërtuar nga nëna e tij, por ajo ka qenë një grua në moshë dhe kjo nuk e bindi trupin gjykues, pasi subjekti i rivlerësimit ka jetuar sëbashku me nënën gjatë gjithë kohës. Subjekti i rivlerësimit nuk mundi të provojë me ndonjë dokumentacion ligjor vlerën e vetëdeklaruar prej 2.500.000 lekësh, për ndërtimin e kësaj prone, e cila në fakt është disa herë më e ulët se vlera mesatare e përcaktuar për vitin 1997, pa llogaritur se kjo pronë mund të jetë ndërtuar edhe më vonë, deri në vitet 2002– 2006 (koha kur ka aplikuar për legalizim). I vetmi shpjegim i subjektit të rivlerësimit ishte lidhur me çmimin e tullave, që nëpërmjet deklaratimeve, ai ishte i ulët. Por, përsëri, ai nuk e bindi dot trupin gjykues se vlera ishte ajo e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit.

52. Trupi gjykues vlerëson se vlera minimale e përlllogaritur nga Komisioni për ndërtimin e sipërfaqes shtesë, duke marrë në konsideratë edhe çmimin më të ulët të tullave, përsëri është më e lartë se ajo e vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Ai nuk justifikon me të ardhura të ligjshme burimin e krijimit të kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaratim të rremë, lidhur me sipërfaqen totale ndërtimore prej 395.3 m<sup>2</sup>, dhe se ai nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie.

**53. Makinë tip “Mercedes-Benz”,** prodhim i vitit 1999, blerë më datë 14.04.2005. Vlera 900.000 lekë + 325.000 lekë taksë. Pjesa që zotëron subjekti i rivlerësimit: 100 %.

54. Mënyra e fitimit: Kontratë shitblerjeje, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.04.2005, për automjetin me targa \*\*\* (në vlerën 900.000 lekë + 325.000 lekë taksë zhdoganimi).

55. Burimi i krijimit: Shuma 900.000 lekë nga të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe vlera e doganës në shumën 325.000 lekëpaguar nga të ardhurat e nënës (si dhuratë).

56. Blerja e kësaj makine është deklaruar nga subjekti fillimisht në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005. Në deklaratën “Vetting”, subjekti shprehet se makina ka kushtuar 900.000 lekë + 325.000 lekë taksa e zhdoganimit.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

57. Është kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dosja e këtij automjeti, nga e cila rezultoi se makina me targa \*\*\* është blerë me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.04.2005, për vlerën 900.000 lekë + 325.000 lekë taksë zhdoganimi.

58. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nëna i ka dhuruar<sup>3</sup> vlerën prej 325.000 lekësh për taksën e zhdoganimit. Ai nuk e ka shoqëruar me ndonjë dokumentacion ligjor provues mundësinë e nënës për këtë dhurim. Në sqarimet e dhëna, subjekti i rivlerësimit sqaron se nëna ka qenë personi që mbante lekët e familjes, nga të cilat edhe kursente.

59. Nga analiza e situatës financiare për vitin 2005, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e makinës (pa përfshirë vlerën prej 325.000 lekësh taksë

<sup>3</sup> Mundësitë financiare të nënës trajtohen më poshtë, te dhuratat.

zhdoganimi), pasi likuiditetet e krijuara dhe shpenzimet e bëra gjatë këtij viti, në këtë analizë, nuk janë të mjaftueshme. Shuma prej 544.636 lekëshjanë shpenzime të deklaruara të pajustificuara me të ardhurat e vërtetuara.

60. Subjekti i rivlerësimit sqaroi se blerja e makinës nuk është produkt vetëm i vitit 2005, por i shumë viteve punë.

61. Trupi gjykues vlerësoi se analiza ekonomike është e shtrirë ndër vite dhe ajo pasqyron të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet ndër vite të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe rezulton se ai nuk ka likuiditete të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

**62. Automjet tip “Ford”,** viti i prodhimit 1998, në vlerën (300.000 lekë). Pjesa zotëruese e bashkëshortes, znj. M. L (Gj.): 100%.

63. Mënyra e fitimit: Kontratë shitblerjeje, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.10.2008, për automjetin tip “Ford”, me vlerë 1.000 euro, të paguar jashtë zyrës noteriale.

64. Blerja e kësaj makine është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2008, në vlerën 300.000 lekë. Në kontratën e shitblerjes vlera është përcaktuar 1.000 euro dhe dogana në shumën 177.940 lekë (është paguar në Zyrën Doganore Korçë).

65. Nga analiza financiare e kryer për këtë vit, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për blerjen e pasurisë.

**66. Makinë tip “Mercedes-Benz”,** e vitit 2006, blerë në vlerën 11.500 euro, më datë 03.10.2014, nga dy djemtë e subjektit të rivlerësimit, P. dhe I. L. Pjesa zotëruese e secilit nga djemtë 50%.

67. Mënyra e fitimit: Kontratë shitblerjeje makine, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 03.10.2014, shitës A. Gj, blerës P. dhe I. L.

68. Burimi i krijimit: Tërheqje depozite në “Credins Bank”, më datë 03.10.2014, vlera 5.500 euro për secilin vëlla për blerjen e makinës dhe mbyllje llogarie.

69. Shumat në vlerën 5.500 euro për secilin nga djemtë janë dhuruar nga gjyshi. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratën noteriale, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.08.2014, ku z. G. Gj deklaron se më **datë 22.08.2014**, ka çelur dy depozita bankare:

- në emër të nipit, P. Sotiraq Lubonja, pranë “Credins Bank”, dega Korçë, në vlerën prej 5.500 eurosh, nr. klienti \*\*\*;
- në emër të nipit, I. Sotiraq Lubonja, pranë së njëjtës bankë, në vlerën prej 5.500 eurosh, nr. klienti \*\*\* .

70. Në këtë deklaratë, z. G. Gj shprehet se kjo shumë përbëhet nga pensioni i tij nga viti 1999. Këto depozita janë konfirmuar dhe nga “Credins Bank”. Paratë janë derdhur në depozitë nga gjyshi, në datën 22.08.2014, dhe janë tërhequr në datën 03.10.2014, e më tej kjo depozitë është mbyllur.

71. Blerja e kësaj makine është deklaruar nga djemtë e subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014, në vlerën 11.500 euro.

72. Është kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dosja e këtij automjeti. Nga kjo drejtori është përcjellë dosja e mjetit tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 2006.

**73. Makinëtip “Mercedes-Benz”,**- është blerë në Gjermani në vitin 2016, ka ardhur në Shqipëri me karroatrec, riparuar për shkak të dëmtimit. Ajo është blerë në vlerën 1.900 euro. Për makinën

janë kryer riparime në vlerën 568.25 euro + 178.572,74 lekë shërbime. Pjesa që zotëron secili nga djemtë e subjektit: 50%.

74. Mënyra e fitimit: Kontratë shitblerjeje e datës 04.02.2016, shitës një shtetas i huaj dhe blerës P. L.

75. Burimi i krijimit: Blerë me kursimet e familjes.

76. Blerja e këtij automjeti është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe djemtë e tij, P. dhe I. L, në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016, duke u shprehur për blerjen e një makine të dëmtuar, në vlerën 1.900 euro + riparime 568,25 euro + 178.572,74 lekë shërbime. Subjekti ka vënë në dispozicion 14 foto të automjetit nga Gjermania në Shqipëri.

77. Është kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dosja e këtij automjeti. Nga kjo drejtori është përcjellë dosja e mjetit tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 2004.

78. Trupi gjykues, nga analiza financiare vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për pasurinë dhe shpenzimet e këtij viti.

**79. Gjatë vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar së bashku me familjen në SHBA,** ku ka rezultuar se bashkëshortja dhe dy fëmijët kanë qëndruar për një periudhë 63-ditore, respektivisht 25.06.2008 - 27.08.2008, ndërsa vetë subjekti i rivlerësimit ka qëndruar 38 ditë, duke u kthyer në Shqipëri në datë 20.07.2008. Sipas metodologjisë së përdorur nga Komisioni (bileta udhëtimi dhe një tarifë ditore prej 20 eurosh dita për person, duke qenë se ka jetuar te të afërmit), rezulton se vetëm shpenzimet për udhëtim dhe qëndrim në SHBA janë në shumën 904.160 lekë.

80. Është pyetur subjekti i rivlerësimit lidhur me koston mesatare të shpenzimeve të udhëtimit dhe të qëndrimit në SHBA dhe harxhimet e kryera për afërsisht në këtë udhëtim. Në përgjigje të pyetjeve të datës 10.07.2018, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se ato janë përballuar të gjitha nga familja Gj. (vjehtëri, vjehtëra) e se ai nuk ka pasur asnjë shpenzim për këtë udhëtim (përfshirë edhe biletat e udhëtimit).

**81. Gjatë viteve 2010 - 2016 rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij, së bashku apo veç e veç, kanë udhëtuar në SHBA** disa herë. Sipas metodologjisë së përdorur nga Komisioni (bileta udhëtimi dhe një tarifë ditore prej 20 eurosh në ditë për person), rezulton se vetëm shpenzimet për udhëtim dhe qëndrim në SHBA janë në shumën 2.834.520 lekë.

82. Është pyetur subjekti i rivlerësimit lidhur me koston mesatare të shpenzimeve të udhëtimit dhe të qëndrimit në SHBA dhe harxhimet e kryera për afërsisht në këtë udhëtim. Në përgjigje të pyetjeve të datës 10.07.2018, subjekti i rivlerësimit është përgjigjur se ato janë përballuar të gjitha nga familja Gj. (vjehtëri, vjehtëra dhe kunati) e se ai nuk ka pasur asnjë shpenzim për këto udhëtime (përfshirë edhe biletat e udhëtimit).

83. Subjekti i rivlerësimit dhe familjarët e tij rezultojnë se kanë udhëtuar edhe në vende të tjera, duke filluar nga viti 2004 e në vijim. Nga analiza financiare rezulton se ai mbulon shpenzimet për këto udhëtime.

84. Likuiditete të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

- a) Gjendje *cash* në vlerën 1.000.000 lekë;
- b) Ripërtëritje bono thesari viti 2016, vlera 5.000.000 lekë, znj. M. L;
- c) Ripërtëritje bono thesari, datë 08.09.2016, vlera 4.150.000 lekë, znj. M. L;
- ç) Ripërtëritje me afat dyvjeçar e depozitës në “Credins Bank”, vlera 4.679,96 USD, pjesa 100%, P. L;
- d) Ripërtëritje e llogarisë në “Credins Bank” në lekë, vlera 419.818,35 lekë, pjesa 100%, z. P. L;

- dh) Ripërtëritje me afat 2-vjeçar e depozitës në “Credins Bank”, vlera 4.783,70 USD, pjesa 100%, z. I. L;
- e) Ripërtëritje e llogarisë në “Credins Bank” në lekë, vlera 431.432,14 lekë, pjesa 100%, z. I. L.

**Hetimi i kryer nga Komisioni:**

- a) Gjendje *cash* në vlerën 1.000.000 lekë.

85. Subjekti ka deklaruar në deklaratën periodikevjetore të vitit 2015 kursime në vlerën 500.000 lekë dhe në deklaratënperiodike vjetore të vitit 2016 kursime në vlerën 500.000 lekë (*në total 1.000.000 lekë të deklaruara në deklaratën “Vetting”*). Gjatë këtyre dy viteve, subjekti i rivlerësimitka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e këtyre kursimeve.

- b) Ripërtëritje bono thesari viti 2016, vlera 5.000.000 lekë, znj. M. L.
- c) Ripërtëritje bono thesari, datë 08.09.2016, vlera 4.150.000 lekë, znj. M. L.

86. Banka e Shqipërisë konfirmon se znj. M. L ka në total bono thesari në vlerën 9.150.000 lekë.

87. Nga analiza financiare e kryer për krijimin e këtyre likuiditeteve konstatohet se si burim përkrijimin e tyre kanë shërbyer:

- i. dhurimi prej 25.000 USD nga babai i saj, depozituar më datë13.06.2005, në llogarinë personale të znj. M. L, pranë “Raiffeisen Bank”. Këtë vlerë ajo e kalon në vitin 2007 në bono thesari (3.000.000 lekë);
- ii. vlera 3.000.000 lekë, e lënë para vdekjes nga nëna e subjektit të rivlerësimit më datë20.09.2012. Këtë shumë bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit e kalon në bono thesari në vitin 2013;
- iii. pjesa tjetër e bonove të thesarit (*9.150.000 lekë - 6.000.000 lekë = 3.150.000 lekë*) nga kursimet e subjektit dhe bashkëshortes në vite.

- c) Ripërtëritje me afat 2-vjeçar e depozitës në “Credins Bank”, vlera 4.679,96 USD, pjesa 100%, z. P. L.
- d) Ripërtëritje e llogarisë në “Credins Bank” në lekë, vlera 419.818,35 lekë, pjesa 100%, z. P. L.
- dh) Ripërtëritje me afat 2-vjeçar e depozitës në “Credins Bank”, vlera 4.783,70 USD, z. I. L.
- e) Ripërtëritje e llogarisë në “Credins Bank” në lekë, vlera 431.432,14 lekë, pjesa 100%, z. I. L.

88. Këto llogari konfirmohen nga “Credins Bank”. Si burim për krijimin e tyre kanë shërbyer derdhjet mujore nga prindërit, si dhe dy dhurime nga gjyshi G. Gj, në vlerën prej 2.500 USD për secilin prej djemve. Në total 5.000 USD vlerë e dhuruar, sipas deklaratës noteriale të datës 25.08.2015 në SHBA, e përpiluar nga noter A. A.

89. Nga hetimi administrativ rezulton se dhurimet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë viteve dhe në përgjigje të pyetësorëve janë (a) nga nëna e tij, znj. F. L, në shumën totale 4.075.000 lekë, si dhe (b) dhurime të kryera nga vjehrra dhe vjehrra, G. dhe P. Gj, si dhe pagesat e shpenzimeve të udhëtimeve nga këta persona dhe kunati i subjektit të rivlerësimit, të tre këta persona me banim në SHBA, siç janë përshkruar më poshtë.

- a) *Dhurime të kryera nga nëna, F. L, në vlerën totale 4.075.000 lekë.*

90. Burimi i deklaruar i krijimit: Dhurata nga nëna si administruese e kursimeve familjare.

91. Veprime dhurimi të kryera nga nëna e subjektit janë:

1. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003 ka deklaruar vlerën 1.500.000 lekë, shumë kjo e përbërë nga kursimete subjektit, si dhe lekë të dhuruara nga nëna.
2. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 ka deklaruar se vlera e doganës prej 325.000 lekësh për blerjen e makinës tip “Mercedes-Benz” është paguar nga nëna në formë dhurimi.
3. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2012 ka deklaruar se nëna, para vdekjes, (20.09.2012) i ka lënë shumën 3.000.000 lekë.

92. Në dosjen e ILDKPKI-së, subjekti i rivlerësimit ka një paraqitur vërtetim bankar të datës 28 dhjetor 2000, ku vërtetohet se znj. F. L ka pranë “BKT”-së llogari në vlerën 4.000.000 dhrahmi, ose 10.071 USD.

93. Po ashtu, gjenden edhe tri deklarata të thjeshta të firmosura nga dy motrat dhe vëllai i znj. F. L, ku shprehen se e kanë ndihmuar motrën e tyre për shkak të sëmundjes së saj, respektivisht: vëllai P. Dh, në vlerën 4.700 USD; motra A. D, në vlerën 4.500 USD, plus shpenzimet e udhëtimit dhe ato mjekësore në vitin 2008 në SHBA, dhe motra L. F, në vlerën 450.000 lekë.

94. Subjekti rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokument justifikues mbi likuiditetet e znj. F. L. Sipas nenit 32, pikat 3 dhe 4, të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti duhet të shpjegojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit dhurues. Trupi gjykues nga analiza ekonomike mbi të ardhurat e deklaruara për nënën (pensioni) vlerësoi se nuk rezultoi e mundur kursimi i kësaj shume të dhuruar.

95. Në raportin e vlerësimit të ILDKPKI-së për këto dhurime rezultoi:

➤ *Deklarim i rremë i subjektit në lidhje me shumën prej 3.000.000 lekësh dhuruar nga nëna (dhe përdorur nga bashkëshortja për investim në bono thesari), pasi dokumentacioni i paraqitur nuk është i mjaftueshëm për të vërtetuar burimin financiar të nënës dhe as të dhuruesve. Kjo shumë e investuar në vitin 2013 në bono thesari nuk është e justifikuar me burime të ligjshme financiare nga ana e subjektit.*

**96. Sa më sipër, subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës për të provuar me dokumentacion ligjor burimin e ligjshëm të të ardhurave, të dhuruara nga ana e nënës, në shumën totale prej 4.075.000 lekësh.**

97. Në përgjigjet e subjektit të rivlerësimit ai shpjegon se familja kishte një mënyrë organizimi ku, nëna (*mamaja e subjektit*) mbante të gjithë llogarinë e shtëpisë, subjekti mbante një pjesë që e administronte me bashkëshorten dhe fëmijët. Të ardhurat, të cilat përbëheshin nga paga e subjektit, paga e bashkëshortes dhe pensioni i mamasë, administroheshin prej nënës dhe ajo kishte arritur të kursente një shumë të ardhurash. Shuma e trashëguar nga nëna pas vdekjes ishte si rezultat i miradministrimit të të ardhurave të depozituara nga ne tek ajo.

98. Nga subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit ndonjë dokument ligjor justifikues, apo provues, mbi likuiditetet e znj. F. L (përveç të ardhurave nga pensioni).

99. Referuar ISSH-së, rezultoi se që nga viti 1996 nëna e subjektit ka pasur të ardhura si pensioniste, e sipas deklarimeve të subjektit, ka qenë me probleme të vazhdueshme shëndetësore. Ndërsa, dokumentacioni i paraqitur nga të afërmit e subjektit, për ndihma në drejtim të nënës së tij, nuk është provues dhe ligjor, përveçse këto ndihma, siç është deklaruar, kanë qenë për të përballuar shpenzimet mjekësore të saj gjatë viteve.

100. Nga analiza financiare e të ardhurave ndër vite, si dhe shpenzimeve të jetesës dhe atyre të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, nuk rezultoi i mundur kursimi nga nëna

i vlerave të pretenduara. Duhet mbajtur në konsideratë fakti se edhe vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar (në deklaratimet vjetore periodike) kursime familjare ndër vite nga të ardhurat.

101. Trupi gjykues nuk u bind për të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke i konsideruar si mungesë burimesh financiare të ligjshme për të justifikuar vlerat financiare të dhuruara nga nëna. Vetë nëna, kur ka pasur probleme shëndetësore, ka marrë ndihma financiare nga familjarët e saj (vëllai dhe motra).

b) *Dhurime të kryera nga vjehri dhe vjehra, G. dhe P. Gj, si dhe pagesat e shpenzimeve të udhëtimeve nga këta persona dhe kunati i subjektit të rivlerësimit, me banim në SHBA.*

102. Subjekti i rivlerësimit i ka deklaruar këto dhurime në formularin “Vetting”, por nuk ka paraqitur dokumentacion ligjor justifikues për ligjshmërinë e burimit të krijimit, sipas nenit 32 të ligjit nr.84/2016.

103. Veprime dhurimi të kryera nga vjehri dhe vjehra e subjektit janë:

1. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005 ka deklaruar se vjehri, z. G. Gj, më datë 13.06.2005 ka derdhur në “Raiffeisen Bank” në llogarinë e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit shumën 25.000 USD.
2. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2014 ka deklaruar se djemtë e subjektit të rivlerësimit, P. dhe I. L., kanë hapur depozitë, më datë 22.08.2014, pranë “Credins Bank”, secili nga 5.500 euro. Në total 11.000 euro. Si burim për këto depozita ka shërbyer dhurimi i gjyshit G. Gj.
3. Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2015 ka deklaruar se vjehri dhe vjehra me deklaratë (me shkrim dore) datë 31.12.2015, u kanë dhuruar pensionin e tyre të vitit 2015 në vlerë 300.000 lekë.
4. Në të njëjtën deklaratë periodike vjetore ka deklaruar dhurim nga vjehri G. Gj për djemtë me deklaratën noteriale (mbajtur në SHBA), datë 25.08.2015, në vlerën 2.500 USD secilit. Pra, në total 5.000 USD.
5. Në përgjigje të pyetësorit standard të dërguar nga Komisioni, ka deklaruar se në vitin 2017 vjehri dhe vjehra i kanë dhuruar pensionin e vitit 2016 në vlerën 500.000 lekë (deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., më datë 28.08.2017). Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2016 nuk është deklaruar dhurimi i pensioneve të personave të tjerë të lidhur (vjehri, vjehra).
6. Subjekti, në përgjigje të pyetësorëve ka deklaruar se shpenzimet e udhëtimit dhe qëndrimit në SHBA, për periudhën 2008-2016 janë paguar nga vjehri, vjehra, si dhe kunati (familja Gj.). Sipas metodologjisë së Komisionit, këto shpenzime janë përlllogaritur në vlerën 3.738.680 lekë.

104. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, me shkresën nr. \*\*\*, datë 28.12.2017, konfirmon se nuk rezultojnë raportime për shtetasit G. e P. Gj.

105. Në raportin e vlerësimit, lidhur me këto dhurime, ILDKPKI-ja shprehet:

*“Deklarim i rremë në lidhje me burimin e krijimit të bonove të thesarit në shumën 25.000 USD, në vitin 2007, pasi dokumentacioni i paraqitur për vjehrin e subjektit, shtetasin G. Gj (me banim në SHBA që nga viti 1999) nuk provon mundësinë e tij financiare për shumën e derdhur fillimisht në “Raiffeisen Bank” prej 25.000 USD, në emër të vajzës së tij. Mungesë burimesh të ligjshme financiare për të krijuar depozitën në vitin 2005, e më pas kalimin në bono thesari.”*

**106. Subjektit të rivlerësimit i kaloi barra e provës, për të paraqitur shpjegime dhe prova bindëse mbi arsyet e financimit të udhëtimeve, si dhe mundësitë financiare të dhuruesve për shumat e shpjeguara më lart, ku vlera totale shkon në 9.296.340 lekë.**

Dhurime nga vjehrrri, vjehrra dhe kunati	2005	2014	2015	2016	2010 - 2016	TOTAL
Bashkëshortes 25.000 USD	2.583.250					<b>2.583.250</b>
Djemve 11.000 Euro		1.541.210				<b>1.541.210</b>
Djemve 5.000 USD			633.200			<b>633.200</b>
Bashkëshortes ( <i>pensionin e vitit</i> )			300.000			<b>300.000</b>
Bashkëshortes ( <i>pensionin e vitit</i> )				500.000		<b>500.000</b>
Shpenzime udhëtimi në SHBA, 2010 - 2016					2.834.520	<b>2.834.520</b>
Shpenzime udhëtimi në SHBA, viti 2008						<b>904.160</b>
	2.583.250	1.541.210	933.200	500.000	2.834.520	<b>9.296.340</b>

107. Për sa u përket veprimeve të dhurimit nga ana e vjehrrit, vjehrrës e kunatit, subjekti i rivlerësimit sqaron se ka qenë kënaqësia e tyre dhe dëshira e tyre, si edhe mundësitë financiare për të mikpritur nipërit dhe familjen e vajzës së tyre, ashtu siç është tradita e familjeve shqiptare, e aq më tepër të gjakut të tyre, në një kohë që nuk kanë qenë afër rritjes e ecurisë në vite të nipërve, duke e shprehur jo vetëm me dhurime, por edhe me mbulimin e shpenzimeve të udhëtimit. Dhe as që bëhet fjalë për mosmarrjen përsipër edhe të shpenzimeve të tjera, si ushqime, veshje etj.gjatë kohës së qëndrimit në SHBA.

108. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur deklaratat e të ardhurave, pas taksave, për vitet 2006-2010, të vjehrrit dhe vjehrrës në SHBA, ku rezulton se ata kanë të ardhura 35.000 USD në vit. Ata kanë përfituar edhe pensione në Shqipëri, të cilat për vitet 1998- 2018 shkojnë në vlerën totale prej 6.233.078 lekësh, duke përfshirë edhe pensionin suplementar të vjehrrit. Të ardhurat e vjehrrit dhe vjehrrës nuk rezultojnë të larta.

109. Ka paraqitur edhe dokument mbi të ardhurat e kunatit (*federal adjusted gross income*) për vitet 2010, 2013, 2014, nga ku rezulton se ai ka të ardhura të mira në familjen e tij.

110. Në përfundim trupi gjykues nuk u bind nga shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit mbi të kundërtën e rezultateve të hetimit, duke i konsideruar të pajustificuara dhuratat e bëra subjektit të rivlerësimit në shumën prej 9.296.340 lekësh nga vjehrrri dhe vjehrra.

#### **Hetime të tjera të kryera nga Komisioni**

111. Nga Zyra e Regjistrimit Noterial Shqiptar u informuam se djemtë e subjektit të rivlerësimit, P. dhe I. L., kanë nënshkruar një kontratë porosie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 01.03.2018.

112. Lidhur me këtë fakt, Komisioni iu drejtuar noterës, nga ku mori një kopje të kontratës mes palëve. Më tej iu drejtua shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., lidhur me çmimin e aplikuar për blerësit, si dhe mandatet e pagesave të kryera deri në muajin shtator nga ana e djemve të subjektit të rivlerësimit.

113. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. informoi se shtetasit P. dhe I. L kanë nënshkruar një kontratë porosie, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 01.03.2018, me këtë shoqëri, për apartamentin nr. \*\*\*, i ndodhur në shkallën \*\*\*, kati i \*\*\* banim (3+1), me sip. totale 125.6 m<sup>2</sup>, së bashku me sipërfaqet e përbashkëta dhe një vend për parkim. Vlera e përcaktuar në kontratë është 79.000 euro + 5.000 euro vendi i parkimit, në objektin që po ndërtohet nga kjo shoqëri në Rrugën e \*\*\*, në total vlera është 84.000 euro.

114. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dërgoi kontratën e lidhur mes palëve, vlerën e paguar deri në datën 16.07.2018 nga porositësit, në masën 53.919 euro, duke bashkëlidhur dhe një mandat bankar për vlerën 15.000 euro.

115. Në lidhje me këto fakte, u pyet subjekti i rivlerësimit, i cili paraqiti urdhër pagese nga “Union Bank”, të datës 30.04.2018, për çlirimin e bonove të thesarit në vlerën 38.819 euro dhe kalimin në po të njëjtën datë ndaj shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*”.

116. Trupi gjykues vlerësoi se, subjekti i rivlerësimit duket sikur ka patur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie, porse burimi i krijimit të bonove të thesarit kanë qenë dhurimet e vjehrrit dhe të mamasë, trajtuar më sipër në këtë vendim, të cilin trupi gjykues nuk e ka pranuar si burim të ligjshëm.

### ***Konkluzione për vlerësimin e pasurisë***

117. Nga vlerësimi i pasurisë rezulton se referuar nenit D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim apo përdorim të tij, duke mos paraqitur saktëkohën kur është kryer ndërtimi i shtëpisë, sipërfaqen reale të shtesës (*ndërtim pa leje*) dhe kërkesën për legalizimin e objektit të ndërtuar pa leje.

118. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi ai ka treguar një sipërfaqe tjetër, nga ajo reale, për banesën e tij në Korçë, duke kryer fshehje të pasurisë, si dhe subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë e ndërtuar. Ai ka kryer deklaram të rremë lidhur me vlerën e ndërtimit të pronës.

119. Ndërtimi pa leje në tokën e dikujt tjetër ka qenë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi. Posedimi i sendit (*truallit*) nga personi jopronar ka qenë në mirëbesim dhe kjo e ka penguar subjektin të paraqesë kërkesë për leje ndërtimi sipas ligjit të asaj kohe, duke kryer kështu ndërtim pa leje dhe duke mos deklaruar kërkesën për legalizimin e objektit të ndërtuar pa leje.

120. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim të ardhurash, për shpenzime të kryera në jetën e tij (udhëtime), por edhe për blerjen e disa pasurive të cituara më lart në vendim, të ardhura të krijuara nga dhurimet nga vjehrrit dhe vjehrra, por edhe kunati. Megjithëse subjekti i rivlerësimit paraqiti një dokument lidhur me të ardhurat vjetore të tyre në SHBA dhe Shqipëri, trupi gjykues nuk u bind lidhur mbi mundësitë financiare të dhuruesve, pasi në asnjë rast të shpjeguar më lart në vendim, subjekti nuk mundi të provojë se ato para kishin ardhur në ndonjë formë që të mund të provohej përfitimi i tyre (transferte bankare, deklarim në kufij) dhe se ato dhurime krijuan dyshime për trupin gjykues.



Trupi gjykues e konsideron si deklaram të rremë burimin e krijimit të dhuratave të përfituara nga vjehri dhe vjehra, duke konstatuar mungesë burimesh financiare të ligjshme për të krijuar shumat e dhuruara, si dhe mungesë e dokumentacionit ligjor provues, për realizimin e dhurimeve.

Mbetet e padokumentuar mënyra e dërgimit nga SHBA-të shumës 5.000 USD, për djemtë P. dhe I. L, në vitin 2015, si dhe pamundësi financiare e shtetasit G. Gj për dhurimin e shumës prej 25.000 USD në vitin 2005.

121. Mbështetur në analizën financiare, të kryer nga Komisioni, rezulton se nëna ka qenë në pamundësi për realizimin e të ardhurave të deklaruara të kursyera, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se deri në vitet 2002-2003, të ardhurat familjare kanë shërbyer tërësisht për ndërtimin e shtëpisë në Korçë, po ashtuedhe faktin se vetë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime ndër vite.

122. Trupi gjykues, bazuar në provat që disponoi, në vlerësimin në tërësi të dhuratave të përfituara dhe mënyrës se si ato janë realizuar, nuk u bind lidhur me ligjshmërinë e dhurimeve, duke i konsideruar ato si deklaram të rremë nga ana e subjektit të rivlerësimit.

123. Mbështetur në analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur likuiditete të mjaftueshme për blerjen e makinës tip “Mercedes-Benz” më datë 14.04.2005, prodhim i vitit 1999.

124. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

125. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, ajo ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 02.11.2017, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku ka konstatuar “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja”. Ky raport është i deklasifikuar.

Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

### ***Konkluzione për vlerësimin e kontrollit të figurës***

126. Nga hetimi administrativ nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës. Deklarimet e subjektit të rivlerësimit rezultuan të sakta dhe të vërteta.

127. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **C. VERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

### **Aftësitë profesionale**

128. Njohuritë ligjore - Subjekti i rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e

zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për rëndësinë e natyrës së mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes.

129. Arsyetimi ligjor - Subjekti i rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme.

130. Struktura e vendimeve të tij është e qëndrueshme dhe e organizuar. Ajo përmban elementet e kërkuara nga legjislati procedural penal apo civil. Subjekti i rivlerësimit nuk mban të njëjtin stil në hartimin e akteve, por organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

131. Gjatë periudhës së rivlerësimit, për gjyqtarin Sotiraq Lubonja janë verifikuar nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, ndër të tjera, 2 ankesa për shkelje etike (*një në vitin 2014 dhe një në vitin 2015*). Të dyja ankesat janë arkivuar pas verifikimit, me arsyetimin se shkeljet e pretenduara nuk janë vërtetuar. Nga ana tjetër, ndaj gjyqtarit Sotiraq Lubonja, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur ndonjë kërkesë për procedimin disiplinor. Po ashtu, nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

132. Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

### **TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLD-SË**

133. Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013- 8 tetor 2016, për gjyqtarin Sotiraq Lubonja janë paraqitur 10 ankesa (*dy në vitin 2013, gjashtë ankesa në vitin 2014, një në vitin 2015 dhe një në vitin 2016*) në Inspektoratin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

134. Pesë ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar dhe konkretisht: tri ankesa me arsyetimin se pretendimet mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor (*dy të vitit 2013 dhe një e vitit 2014*), një ankesë e vitit 2014 me arsyetimin se pretendimet janë jashtë afatit, ndërsa një ankesë e vitit 2014 me arsyetimin se është ankesë e përsëritur.

135. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Sotiraq Lubonja, përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### **Denoncimet pranë Komisionit**

*136. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 19.12.2017*

Denoncuesja u referohet disa subjekteve, nuk është ankesë individuale vetëm për subjektin e rivlerësimit. Objekti: Vendim i padrejtë.

Çështja civile është regjistruar në Gjykatën e Apelit Korçë, nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 26.12.2013, dhe vendimi i kësaj gjykate nr. \*\*\* është dhënë më datë 16.07.2014. Në Gjykatën e Apelit Korçë kryesues ka qenë subjekti i rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja.

Kundër vendimit të dhënë në Gjykatën e Apelit Korçë është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili pritet ende të shqyrtohet nga kjo gjykatë.

Pretendimet e paraqitura në ankesë kanë të bëjnë me rrethana dhe fakte, të cilat zgjidhen në rrugë gjyqësore nëpërmjet apelimit në një gjykatë më të lartë.

*137. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 18.01.2018; nr. \*\*\*, datë 20.04.2018*

Ankesa e paraqitur nga shtetasi u referohet tri subjekteve të rivlerësimit, me objekt kontrollin e figurës, aftësitë profesionale, shkelje ligjore.

Ankuesi shprehet mbi dy çështje civile dhe një penale të lidhur me ekspertimin e rremë në vijimësi të njëjës prej çështjeve civile.

Çështja civile e fundit është regjistruar me nr. \*\*\* regjistri themeltar, datë 23.01.2017. Vendimi nr. \*\*\*, datë 31.10.2017.

Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë.

Gjatë vitit 2018 subjekti i rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, ka qenë anëtar i trupit gjykues për çështjen penale.

Pasi kontaktuam me denoncuesin, u bëmë me dije se pas kërkesës së palës, është dhënë dorëheqja nga gjykimi i çështjes penale në Gjykatën e Apelit Korçë nga subjekti i rivlerësimit.

*138. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 26.01.2018; nr. \*\*\*, datë 02.02.2018; nr. \*\*\*, datë 02.02.2018*

Ankesa e paraqitur nga shtetasja u referohet disa subjekteve, nuk është individuale.

Objekti i denoncimit: Hetim jo i rregullt ligjor, i pabazuar në prova, aftësi profesionale. Vendim i padrejtë, aftësi profesionale.

Ankuesja denoncon një çështje penale kundër mjekut për kryerjen e veprës penale “Mjekim i pakujdesshëm”, parashikuar nga neni 96 i Kodit Penal.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, në përfundim të gjykimit ka vendosur: Deklarimin fajtor të të pandehurit për kryerjen e veprës penale “Mjekimi i pakujdesshëm”.

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim i pandehuri dhe avokati i tij.

Gjykata e Apelit Korçë, me kryesues subjektin e rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë dhe pushimin e çështjes.

Kundër këtij vendimi është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Korçë, i cili nuk është marrë ende në shqyrtim nga kjo gjykatë.

Ankuesja ka paraqitur ankesë në Këshillin e Lartë të Drejtësisë. Sipas shkresës nr. \*\*\*, datë 08.06.2017, të Inspektoratit janë kryer verifikimet, janë marrë deklaratimet e trupit gjykues, përbërë nga gjyqtarët Sotiraq Lubonja etj., të cilët kanë deklaruar se e kanë marrë vendimin në zbatim të ligjit dhe provave të administruara. Duke qenë se dosja ndodhet aktualisht në Gjykatën e Lartë. Inspektorati çmon se në rrethanat e mungesës së shqyrtimit të çështjes penale nga Gjykata e Lartë, nuk mund të konkludohet lidhur me shkeljen ose jo të detyrave gjyqësore të gjyqtarëve.

*139. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 17.04.2018*

Ankesa e paraqitur nga shtetasi u referohet disa subjekteve, nuk është individuale.

Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë është paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili nuk është shqyrtuar ende nga kjo gjykatë.

Vendimi i Gjykatës së Apelit Korçë, nr. \*\*\*, datë 13.10.2016, për çështjen civile me kryesues Sotiraq Lubonja, ndërkohë çështja është regjistruar me nr. \*\*\*, datë 06.02.2017.

Për sa pretendohet, është paraqitur ankesë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë më datë 16.11.2017. Në përfundim është marrë vendimi për arkivimin e ankesës pas shqyrtimit fillestar, duke qenë se pretendimet e ankueses kanë të bëjnë me fakte dhe rrethana që lidhen me vendimmarrjen e gjykatës, e si të tilla ato i nënshtrohen kontrollit gjyqësor.

Denoncuesi ka paraqitur denoncim edhe në emisionin “Stop”, kryesisht për gjyqtarin e Gjykatës së Shkallës së Parë Korçë që ka gjykuar çështjen. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, përmendet vetëm një herë me emër në këtë denoncim televiziv.

*140. Denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 02.02.2018*

Ankesa e paraqitur nga shtetasja u referohet dy subjekteve të rivlerësimit.

Kjo ankesë është e njëjtë me ankesën e denoncuesit të mësipërm (*denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 17.04.2018*) dhe është trajtuar më lart.

141. Denoncimi nr. \*\*\*, datë 27.04.2018

Ankuesi u referohet disa subjekteve, nuk është ankesë individuale vetëm për subjektin e rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja.

Ankuesi denoncon një vendim të Gjykatës së Apelit Korçë, nr. \*\*\*, datë 06.02.2003, ku pjesë e trupit gjykues ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit.

Ndaj këtij vendimi është ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 18.05.2004, vendosi: Lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 06.02.2003, të Gjykatës së Apelit Korçë.

Për sa më sipër, është ezauruar rruga gjyqësore e shqyrtimit të këtij vendimi.

Në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja.

### ***Konkluzione për vlerësimin e aftësive profesionale***

142. Vlerësimi i aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit u bazua në (i) gjetjet e mësipërme dhe (ii) pas një analize të bërë në përputhje me ligjin nr. 84/2016 “Për vlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kreun II të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Në përfundim, relatori i çështjes propozoi për subjektin e rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja: “I aftë”.

143. Trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, rekomandimet e relatorit të çështjes, dhe pasi dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, mbështetur në nenin D, pika 5, të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në provat që disponoi në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, konstaton se subjekti i rivlerësimit:

- a) nuk ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b) ka arritur një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, dhe
- c) ka një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 4 pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Sotiraq Lubonja, me funksion gjyqtar në Gjykatën e Apelit Korçë.

2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall më datë 08.10.2018, ora 10:00.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Suela Zhegu**  
**Kryesues**

**Valbona Sanxhaktari**  
**Relator**

**Brunilda Bekteshi**  
**Anëtar**

Anisa Duka  
Sekretare gjyqësore